


Indeksi i Çmimeve të Importit

Tremujori II, 2024

Tiranë, më 04 Shtator: Indeksi i Çmimeve të Importit, në tremujorin e dytë të vitit 2024, arriti 108,3 kundrejt vitit 2021 si periudha bazë. Krahasuar me tremujorin e dytë 2023, indeksi i çmimeve të importit shënoi një ulje me 1,0 %, një vit më parë ky ndryshim ishte me rritje 0,2 %. Ndryshimi tremujoror i indeksit të çmimeve të importit në tremujorin e dytë 2024, krahasuar me tremujorin e parë 2024 është +0,2 %.

Fig.1: Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



Ndryshimi vjetor: Krahasuar me tremujorin e dytë 2023, çmimet në seksionin “Industri nxjerrëse” shënuan një ulje me 1,5 %, pasuar nga seksioni “Industria përpunuese” me peshën më të madhe prej 93,5 %, shënoi ulje me 1,2 %, “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,2 %. Nga ana tjetër seksioni “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” shënoi rritje me 1,0 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese” ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 6,2 %, pasuar nga “Konfeksionimi i veshjeve” me 4,6 %, “Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi” me 3,8 %, “Përpunimi i tekstilëve” me 2,7 %, “Përpunimi i produkteve ushqimore”, “Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës” dhe “Metalurgjia” me 2,3 % secili, “Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t” me 1,5 %. Nga ana tjetër çmimet në aktivitetin “Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar” shënuan rritje me 3,4 %, pasuar nga aktivitetet “Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit” me 1,5 %, “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure” me 1,0 %, “Industri të tjera p.k.t” me 0,9 %, etj.

Për publikim 04/09/2024

Vijon

Ndryshimi Tremujor: Krahasuar me tremujorin e parë 2024, çmimet në seksionin “Industria nxjerrëse” shënuan rritje me 0,6 %, pasuar nga seksionet “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,5 %, “Industria përpunuese” me 0,3 %. Nga ana tjetër seksioni “Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar” shënoi ulje me 0,7 %. Brenda seksionit “Industria përpunuese” rritja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Prodhimi i mobiljeve” me 1,2 %, pasuar nga “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 1,0 %, “Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve” me 0,9 %, “Përpunimi i tekstileve” dhe “Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike” me 0,8 % secili. Nga ana tjetër çmimet e aktivitetit “Konfeksionimi i veshjeve” shënuan ulje me 1,3 %, pasuar nga “Metalurgjia” me 0,7 % dhe “Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë” me 0,3 %.

Tab.1: Indeksi i Çmimeve të Importit

2021=100

NVE Rev2	Përshkrimi	Peshat	04-24	05-24	06-24	II-24
	Gjithsej	100	108,3	108,2	108,4	108,3
B	Industri Nxjerrëse	0,2	112,0	112,2	112,2	112,1
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	112,0	112,2	112,2	112,1
C	Industria Përpunuese	93,5	106,5	106,6	106,6	106,6
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,3	113,3	113,5	113,3	113,3
11	Prodhimi i pjëve	3,1	114,2	113,4	113,3	113,6
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	103,3	103,3	103,3	103,3
13	Përpunimi i tekstileve	4,4	105,6	105,3	105,4	105,4
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	103,1	103,1	103,1	103,1
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,8	104,0	104,0	104,1	104,0
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	2,5	101,5	101,9	101,7	101,7
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	2,3	106,5	106,5	106,5	106,5
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	110,9	110,9	110,9	110,9
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	9,8	108,0	108,0	107,7	107,9
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,6	105,9	105,9	105,9	105,9
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	6,3	100,9	100,9	100,9	100,9
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	99,4	99,4	99,4	99,4
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,6	111,8	111,7	111,7	111,7
24	Metalurgjia	8,6	109,1	109,1	109,2	109,1
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,5	109,1	109,1	109,1	109,1
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,8	105,1	106,2	107,0	106,1
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,6	109,5	109,3	109,3	109,3
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	5,5	101,5	101,3	102,0	101,6
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	110,8	110,7	110,7	110,7
31	Prodhimi i mobiljeve	0,8	102,1	102,1	102,1	102,1
32	Industri të tjera p,k,t	2,0	105,6	105,7	105,6	105,6
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	5,2	146,0	144,0	148,5	146,2
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	5,2	146,0	144,0	148,5	146,2
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,0	108,5	108,5	108,5	108,5
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	108,5	108,5	108,5	108,5

Tab.2: Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

në %

NVE	Përshkrimi	Peshat	II- 24 / I- 24	II- 24 / II- 23
	Gjithsej	100	0,2	-1,0
B	Industri Nxjerrëse	0,2	0,6	-1,5
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	0,6	-1,5
C	Industria Përpunuese	93,5	0,3	-1,2
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	11,3	0,1	-2,3
11	Prodhimi i pjëve	3,1	0,3	0,5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	1,0	-0,2
13	Përpunimi i tekstilëve	4,4	0,8	-2,7
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	-1,3	-4,6
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	2,8	0,3	1,0
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilieve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	2,5	0,1	-3,8
17	Prodhimi i letës dhe produkteve prej letre	2,3	0,3	-0,9
18	Shty pshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,0	0,2	-6,2
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	9,8	0,3	-0,3
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,6	0,6	-0,4
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	6,3	0,8	-1,3
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	0,4	-2,3
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,6	0,1	-0,9
24	Metalurgjia	8,6	-0,7	-2,3
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	3,5	0,9	3,4
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	3,8	-0,3	-1,0
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	5,6	0,6	-0,4
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	5,5	0,3	-1,5
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,3	0,6	1,5
31	Prodhimi i mobilieve	0,8	1,2	-0,4
32	Industri të tjera p,k,t	2,0	0,6	0,9
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	5,2	-0,7	1,0
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	5,2	-0,7	1,0
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbejeve	1,0	0,5	-0,2
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbejeve; rikuperimi i materialeve	1,0	0,5	-0,2

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas,

INSTAT llogarit dhe publikon:

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev,2) në nivel 2-shifror,

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori,

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe tremujorit të mëparshëm.